

Këshilla të përshtatshme për parandalimin e zjarreve në blloqet e apartamenteve



Kjo fletëpalosje është për pronarët e ndërtesave, shoqatat e strehimit dhe qiramarrësit që dëshirojnë të mësojnë më tepër për parandalimin e zjarrit dhe kryerjen e sigurtë të evakuimit në raste të rënies së zjarrit.

Daljet në raste urgjence

Kërkesa bazë për evakuimin e një ndërtese është se gjithmonë duhet të ketë të paktën dy dalje të pavarura në raste urgjence. Nëse një dalje është e bllokuar nga zjarri, atëherë dalja tjetër duhet të jetë e disponueshme. Tek ndërtesat që kanë deri në tetë kate, zakonisht shkallët përdoren si një nga daljet në raste urgjence, dhe një dritare ku shërbimet e shpëtimimit mund të ndihmojnë me evakuimin duke përdorur shkallët, mund të japë një mundësi tjetër.

Tek ndërtesat me më shumë se tetë kate, zakonisht ka vetëm një dalje në raste urgjence, gjë që paraqet kërkesa të caktuara në ndërtimin e shkallëve, për të parandaluar në këtë mënyrë përhapjen e tymrave dhe gazrave. Në mënyrë që të përdorni shkallët, duhet të kaloni një derë përveç derës së shkallëve. Është shumë e rëndësishme që dera që të çon tek shkallët të mbyllet fort dhe të jetë e plotë, si dhe çelësi i derës të punojë siç duhet dhe se shuli i derës të mbërthehet fort në pllakën e sigurimit.

Daljet e urgjencës duhet të mbahen gjithmonë të lira nga objektet që rrinë vetë dhe nga objektet që digjen dhe kjo është arsyeja se përse biçikletat, karrocet, gazetat dhe kutitë mund të mos të mbahen në shkallë, qoftë dhe përkohësisht.

Rrugët anësore

Disa ndërtesa kanë rrugë ndihmëse anësore, si kusht të vënë nga leja e planifikimit dhe këto rrugë anësore janë një domosdoshmëri absolute në rast të evakuimeve dhe rënieve të zjarrit. Rrugët anësore duhet të jenë të dukshme mirë, të mos bllokohen dhe të pastrohen nga bora gjatë muajve të dimrit.

Bodrumet dhe papafingot

- Kalimet për në bodrum dhe papafingo duhet të mbahen të lira nga objektet që rrinë vetë dhe nga materialet që digjen.
- Gazrat dhe lëngjet djegëse, ose materialet eksplozive nuk duhet të mbahen në bodrum dhe papafingo.
- Dyert për në bodrum dhe papafingo duhen mbajtur të mbyllura dhe me çelës.

- Duhet të mbizotërojë organizimi i mirë dhe rregull, në mënyrë që të ndihmojnë në parandalimin e zjarreve.

Mbani mend që shumica e sulmeve të zjarrvënies së qëllimshme ndodhin në bodrume, dhomat e mbeturinave, shkallë dhe papafingo. Zjarrvënësit e qëllimshëm nuk kanë vend këtu!

Pajisja e parandalimit të zjarrit

Shumica e blloqeve të apartamenteve në të gjithë vendin i kanë të instaluar pajisjet e parandalimit të zjarrit. Këto mund të jenë, për shembull, amortizatorë ose ventilatorë ndaj tymit, duke lejuar në këtë mënyrë evakuimin e zjarrit dhe tymit nga shkallët, bodrumet dhe garazhet, ose tubacione për të mundësuar transportimin e ujit nga shërbimet e shpëtimimit.

Pajisja e lartpërmendur duhet inspektuar rregullisht, duke i kushtuar vëmendje funksionimit, shenjave dhe ndonjë dëmtimi të mundshëm. Është detyra e pronarëve të ndërtesave/ shoqatave të strehimit të inspektojnë pajisjen.

Çfarë thotë ligji?

Sipas ligjit (2003:778) për parandalimin e aksidenteve 2 kap. 2 § ”pronari, ose banori përfitues duhet të mbajë pajisje për fikjen e zjarrit dhe të shpëtimit të jetës në rast zjarri ose aksidenti tjetër, si dhe të marrë masat e nevojshme për të parandaluar zjarrin dhe të parandalojë ose kufizojë dëmtimet/plagët e shkaktuara nga zjarri”.

Shkurtimisht, ajo që është përmendur më lart do të thotë se që të dy, qira-

marrësit/pronarët e apartamentit dhe pronarët e ndërtesës/shoqatat e strehimit janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Rezidentët duhet të ndjekin rregullat që kanë të bëjnë me ndërtesën e përmendur dhe pronarët duhet të sigurojnë që këto rregulla ekzistojnë dhe se duhet bërë inspektimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të parandalimit të zjarrit.

Alarmet e zjarrit

Ka një fletëpalosje të caktuar për alarmet

e zjarrit, e cila është publikuar nga Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri.

Agjencia e Shërbimeve Kombëtare për Shpëtim ka publikuar gjithashtu këshilla për alarmet e zjarrit në banesa rezidenciale (2007:1). Për informata të mëtejshme shikoni www.brandskyddsforeningen.se dhe www.msbyndigheten.se.

Alarmet e zjarrit mund t’ju shpëtojnë jetën. Sigurohuni që gjithmonë të keni një alarm zjarri që punon në shtëpi.

TELEFONONI GJITHMONË 112 NË RASTE ZJARRI

Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri është një organizatë anëtare, e cila punon për ta bërë Suedinë një vend më të sigurtë. Me anë të informatave dhe trajnimeve, ne i ndihmojmë njerëzit, kompanitë dhe organizatat që të jenë përgjegjëse për parandalimin e zjarrit. 08-588 474 00. www.brandskyddsforeningen.se